HOROSKOPI

Kronikë

13 vitet në arrati të biznesmenit që vrau 2 miqtë laçian për borxhin 100 mijë €! Shtëpia në Fier "mbushur" me armë

Në vitin 2014 Gjykata e Tiranës e ka dënuar me 25 vjet burgim, për vrasje dhe armë pa leje, ndërsa prokuroria kishte kërkuar burg përjetë.

Pjetër Pacani në listën e 50 më të kërkuarve, dhe sot i arrestuar

Redaksia
5 Qershor, 12:59 | **Përditësimi: 5 Qershor, 13:02**

Share

Ishte 48 vjeç kur vrau 2 persona në Laç për një borxh të pashlyer, mbi 100 mijë euro. 13 vite mës pas, Pjetër Pacani, sot 61 vjeç, vështirë se ka ngjashmëri me foton e tij në listën e 50 më të kërkuarve në vend.

Policia ra pas 13 vitesh në gjurmët e tij dhe e arrestoi në Fier.

Pjetër Pacani i lindur në Fushë Kuqe të Laçit ishte strehuar në arrati në apartamentin e një pallati në lagjen "1 Maji" në qytetin e Fierit. Në banesën ku u kap në flagrancë dhe pa e pritur, efektivët i gjetën 3 pistoleta, 1 automatik municion luftarak, granatahedhës dhe 2 antiplumba. Disa nga armët u gjetën në çantë ndërsa kallashi mbi divan mbi disa veshje ushtarake. I veshur i gjithi me të bardha, me mjekrën e gjatë të bardhë, 61-vjeçari shihet teksa shoqërohet nga efektivët, nga banesa drejt automjetit e më tej në drejtorinë e Policisë së Fierit, i habitur në fytyrë si të mos e besonte se gjithçka kishte marrë fund.

LEXO EDHE:
Ndër më të kërkuarit në vend, pamjet e arrestimit të Pjetër Pacanit, si ka ndryshuar pas 13 vitesh! Me automatik në divan e 3 pistoleta

Në vitin 2014 Gjykata e Tiranës e ka dënuar me 25 vjet burgim, për vrasje dhe armë pa leje, ndërsa prokuroria kishte kërkuar burg përjetë.

Ishte 18 janar i vitit 2011, kur Pjetër Pacani, në atë kohë biznesmen ndërtimi, mori një armë me vete, dhe shkoi të vrasë në befasi 2 persona, teksa pinin kafe në një lokal pranë një karburanti në aksin rrugor "Lezhë-Tiranë.

Me 2 miqtë Ndoc Zymajn dhe Vlash Gjeçin nga Laçi, kishte konflikte të vazhdueshme, dhe ishte ofenduar prej tyre me mesazhe në telefon, për një hua mbi 100 mijë euro, që Pacani ua kishte marrë, me kontratë por nuk kishte mundur ta shlyente në afat. Dëshmitarët tregojnë të vetmet fjalë që Pacani tha para se të kryente vrasjen e dyfishtë: "Më shani prapë me nënë e motër". Ndërsa Vlash Gjeçi, teksa ishte ende gjallë ka shqiptuar fjalët: "Na preu në besë".

Pjetër Pacani i vrau duke i qëlluar disa herë me armë e më tej u largua me një automjet "Porche", derisa u arrestua 13 vite më pas.

I konsideruar me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në operacion e arrestimit morën pjesë forcat e Posaçme Operacionale në Policisë Kriminale.

G.M./Shqiptarja.com

TAG: pJETER PACANI | Fier | vlash gjeçi | ndoc zymaj | arratia

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ju duket investigimi i Rai 3 për Shqipërinë?

Korrekt | Jo korrekt | Nuk e di

Lajme të tjera

Një ndër më të kërkuarit në vend, arrestohet pas 13 vitesh Pjetër Pacani! Vrau 2 persona për borxhin 100 mijë euro! Me vete kishte dhe 3 automatikë
4 Qershor, 20:47

Lushnje, ndalohet 48 vjeçari dyshohet se ngacmoi seksualisht një të mitur! I riu grusht arbitrit
4 Qershor, 12:26

Fier, 70 vjeçarit i shpërthen bombola në banesë, në gjëndje të rëndë në spital
3 Qershor, 09:53

Bashkia e Lushnjës derdh ujërat e zeza në tokë bujqësore, Braçe: Dëm kolosal në Divjakë, ose të marrë masa ose përballet shumë keq me ne
1 Qershor, 22:50

Obelisk në Lushnje në nder të kardinalit Dom Mikel Koliqi, në vendin ku vuajti internimin në diktaturë!
31 Maj, 16:42

Fier/ Ra në kontakt me energjinë elektrike, ndërron jetë 60-vjeçari
30 Maj, 19:19

Lushnje/ Plagosi me thikë djalin e tij, arrestohet në flagrancë babai 69-vjeçar
29 Maj, 12:46

Pasuri nga trafiku i drogës, Prokuroria e Fierit sekuestron 6 pasuri të tjera të Saimir Taullaut
28 Maj, 15:52

'Patatet e Divjakës' reportazhi në 'Veri-Jug' në Report Tv
Agim Pipa
26 Maj, 16:41

Lushnje, pjeshkët shiten 60 lek më pak se një vit më parë! Fermerët: Kemi humbje, sezon i mbarë për prodhimin por jo për tregtinë
Yrjet Saliasi
26 Maj, 15:33

Semani çel sezonin veror, ministri Balla fton shqiptarët e Kosovës e Maqedonisës së Veriut ta vizitojnë
25 Maj, 12:56

Qershitë e Fierit/ Fermerët e shesin 50 lekë/ kg, në treg përfundojnë peshkësh më lart
25 Maj, 12:02

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Gerbutto

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje